

CDK pack sh.p.k.

**Pasqyrat Financiare
31 dhjetor 2017**

Permbajtja:

	Faqe
Pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2017	2
Pasqyra e te ardhurave gjithepershireshe per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	3
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	4
Pasqyra e flukseve monetare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017	5
Shenime shpjeguese te pasqyrave financiare	6 - 13

CDK pack sh.p.k.
Pasqyra e pozicionit financiar
me 31 dhjetor 2017

(shumat ne Lek)

	Shenime shpjeguese	31 dhjetor 2017
<u>Aktivet</u>		
I Aktivet afatshkurtra		
Mjete monetare	4	705,196
Aktive te tjera financiare afatshkurtra	5	380,242
Inventari	6	2,075,262
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	7	-
Total i aktiveve afatshkurtra (I)		3,160,700
II. Aktivet afatgjata		
Aktive afatgjata materiale	8	301,529
Aktive afatgjata jomateriale	9	-
Totali i aktiveve afatgjata (II)		301,529
Totali i aktiveve (I,II)		3,462,229
<u>Detyrimet dhe kapitali</u>		
I Detyrimet afatshkurtra		
Detyrimet per t'u paguar dhe parapagimet	10	3,585,745
Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)		3,585,745
II. Detyrimet afatgjata		
Totali i detyrimeve afatgjata (II)		-
Totali i detyrimeve (I,II)		3,585,745
III. Kapitali		
Kapitali themeltar	1	1,000
Kapitali i papaguar		(1,000)
Fitimet (humbjet) e akumuluar		-
Fitimi (humbja) e periudhes financiare		(123,516)
Totali i kapitalit (III)		(123,516)
Totali i detyrimeve dhe kapitalit (I,II,III)		3,462,229

Pasqyra e pozicionit financiar duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6 – 13 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

CDK pack sh.p.k.
Pasqyra e te ardhurave gjithepershires
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(shumat ne Lek)

	Shenime shpjeguese	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
I. Te ardhurat nga shitja		
Te ardhura nga aktiviteti	11	3,547,053
Te ardhura te tjera	12	11,149
Totali i te ardhurave (I)		3,558,202
II. Shpenzimet		
Kosto e mallrave te shitura	13	(2,999,175)
Shpenzime administrative	14	(401,202)
Kosto e punes:		
Pagat e personelit	15	(213,230)
Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	15	(35,610)
Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale	8	(3,313)
Totali i shpenzimeve (II)		(3,652,530)
Tatim fitimi		
Fitimi (humbja) nga veprimtaria kryesore (I-II)		(94,328)
III. Te ardhurat dhe shpenzimet financiare		
Te ardhura (shpenzime) nga kurset e kembimit, neto	16	(17,740)
Te ardhura (shpenzime) te tjera financiare, neto	17	(11,448)
Totali i te ardhurave dhe shpenzimeve financiare, neto (III)		(29,188)
Fitimi (Humbje) para tatimit (I-II-/+III)		(123,516)
Tatim-fitimi	18	-
Fitimi (Humbje) neto i periudhes financiare		(123,516)
Te ardhura te tjera gjithepershires:		
Te ardhura gjithepershires per vitin		-
Fitim/(humbje) i atribues hem per:		
Pronaret e shoqerise meme		(123,516)
Fitimi/(humbja) per vitin		(123,516)
Te ardhura/(humbje) totale te atribueshme per:		
Pronaret e shoqerise meme		(123,516)
Totali i te ardhurave gjithepershires per vitin		(123,516)

Pasqyra e te ardhurave gjithepershires duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6 – 13 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

**CDK pack sh.p.k.
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017**

(shumat ne Lek)

Kapitali i nenshkruar	Kapitali i nenshkruar i papaguar	Fitim (humbja) e akumuluar	Fitim (humbja) e periudhes	TOTALI
Kapitali i nenshkruar	1,000	-	-	1,000
Kapitali i nenshkruar i papaguar	(1,000)	-	-	(1,000)
Kalim ne fitim (humbje) te akumuluar	-	-	-	-
Fitimi (humbja) e periudhes	-	-	(123,516)	(123,516)
Pozicioni me 31 dhjetor 2017	1,000	(1,000)	(123,516)	(123,516)

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6 – 13 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

CDK pack sh.p.k.
Pasqyra e flukseve monetare
per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017


(shumat ne Lek)

	Shenime shpjeguese	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
I. Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit		
Fitimi (humbja) para tatimit		(123,516)
Rregullime per:		
Amortizim	8	3,313
(Rritje) renie ne tepricen e kerkesave te arketueshme	5	(380,242)
(Rritje) renie ne tepricen e inventarit	6	(2,075,262)
(Rritje) renie ne tepricen e parapagimeve dhe shpenzimeve te shtyra	7	-
Rritje (renie) ne tepricen e detyrimeve per t'u paguar	8	3,585,745
Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit		1,010,038
Tatim-fitimi i paguar	16	-
Fluksi neto monetar nga veprimtarite e shfrytezimit		1,010,038
II. Fluksi monetar nga veprimtarite e investimit		
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	8	(304,842)
Shitja e aktiveve afatgjata materiale	8	-
Fluksi neto monetar nga veprimtarite e investimit		(304,842)
III. Fluksi monetar nga veprimtarite e financimit		
Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar		-
Dividendet e paguar		-
Fluksi neto monetar nga veprimtarite e financimit		-
IV. Rritja (zvogelimi) neto i mjeteve monetare		705,196
V. Mjetet monetare ne fillim te periudhes	4	-
VI. Mjetet monetare ne fund te periudhes	4	705,196

Pasqyra e flukseve monetare duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 6 – 13 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare te Shoqerise per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 u aprovuan nga administratori dhe u nenshkruan si me poshte:

Savas Karaca



CDK pack sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(shumat ne Lek)

1. Informacion i pergjithshem

CDK PACKsh.p.k. (referuar si "Shoqeria") eshte regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me date 17 korrik 2017 dhe me Degen e Tatimeve dhe Taksave Tirane me NIPT L71921022V.

Veprimtaria e Shoqerise rregullohet me dispozitat perkatese te Ligjit 9901, date 14 prill 2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", si dhe nga statuti i saj. Ne perputhje me statutin dhe aktin e themelimit, aktiviteti i Shoqerise konsiston ne import-eksport, tregti me shumice dhe pakice, shitje kartoni, perpunim letre, perpunim kartoni, prodhim letre etj. Shoqeria zoterohet nga tre ortak, Znj. Eniana Karaca me 10%, Bariş Karaca me 50% dhe Savaş Karaca me 40%. Me 31 dhjetor 2017 vlera e kapitalit themeltar eshte 1,000 Lek.

Adresa e Shoqerise eshte ne Rr.e Qelqit, Kombinat, ish Fabrika e tullave silikate, me vertetim pronesis Nr.2/293, Tirane, Shqiperi.

2. Bazat e pergatitjes se pasqyrave

2.1 Perputhshmeria

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK) te shpallura me date 15 qershor 2006 ne perputhje me Ligjin 9228, date 29 prill 2004 te ndryshuar me ligjin 9477, date 9 shkurt 2006, dhe te permiresuara ne perputhje me Urdherin e Ministrit te Financave nr.64, date 22.07.2014, ne fuqi nga data 1 janar 2015.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

2.3 Periudhat krahasimore

Te dhenat e periudhave te meparshme jane riklasifikuar per t'i bere ato te krahasueshme me paraqitjen e te dhenave te periudhes ushtrimore.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Keto pasqyra financiare jane prezantuar ne Leke, e cila eshte dhe monedha funksionale e Shoqerise.

2.5 Vleresime dhe gjykime

Pergatitja e pasqyrave financiare kerkon nga drejtuesit te ushtrojne gjykimin e tyre ne procesin e zbatimit te politikave kontabel te kompanise dhe shumave te raportuara te aktiveve, detyrimeve, te ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund te ndryshoje ne varesi te ketyre vleresimeve.

Vleresimet dhe gjykimet rishikohen ne menyre te vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabel jane te njohura ne periudhen ne te cilen vleresimi eshte rishikuar si dhe ne periudhat e ardhshme qe preken.

Ne veçanti, informacionet mbi fushat me te rendesishme te vleresimeve dhe gjykimeve ne aplikimin e politikave kontabel te cilat kane efektet me te rendesishme ne shumat e njohura ne pasqyrat financiare, jane pershkruar ne shenimet perkatese te pasqyrave financiare. Perdorimi i vleresimeve kontabel eshte minimal ne keto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtesine e veprimeve te realizuara nga Shoqeria.

CDK pack sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(shumat ne Lek)

3. Politikat kontabel

Politikat kontabel te meposhtme jane aplikuar ne menyre konsistente nga Shoqeria, pervec rasteve kur specifikohet ndryshe.

3.1 Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e raportimit. Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jomonetare ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit, ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehin ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlere e drejte.

Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare joderivative perbehen nga kerkesa per t'u arketuar, mjete monetare, hua te marra dhe te dhena, dhe detyrime per t'u paguar.

Instrumentat financiare joderivative njihen fillimisht me vleren e drejte plus cdo kosto transaksioni qe lidhet me to, pervec siç pershkruhet me poshte. Per instrumentat e mbajtur me vlere te drejte nepermjet fitim/humbje, koston e transaksionit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Ne vijim te njohjes fillestare instrumentat financiare joderivative maten siç pershkruhet me poshte.

Nje instrument financiar njihet nese shoqeria behet pale ne kushtet kontraktuale te instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te shoqerise mbi flukset e parase se aktivitetit financiar ose kur shoqeria transferon aktivitetin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe perfitimet thelbesore te aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen shoqeria angazhohet te bleje apo te shese aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te shoqerise skadojne, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne te pare me bankat. Per qellimin e pasqyres se flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj perfshijne depozita pa afat me nje maturim prej tre muajsh ose me pak qe nga data e fillimit.

Kerkesa per t'u arketuar

Kerkesat per t'u arketuar njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provigjoni per zhvleresimin e kerkesave per t'u arketuar llogaritet kur ka te dhena se shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshitesite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar dhe mospagesa apo pagesa e vonuar konsiderohen tregues qe llogarite e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provigjontit llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Detyrimet per t'u paguar

Detyrimet per t'u paguar paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metodën e interesit efektiv.

CDK pack sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(shumat ne Lek)

Hua te marra dhe te dhena

Huate e marra dhe te dhena njihen fillimisht me vleren e tregut, pa perfshire koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huate e marra dhe te dhena paraqiten me kosto te amortizuar duke njohur ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve çdo diference midis koston dhe vleres se pagueshme nominale pergjate periudhes se huamarrjes duke u bazuar ne interesin efektiv.

Vlera e drejte

Vlerat e drejta te perlogaritura te mjeteve monetare dhe ekuivalenteve te tyre, te kerkesave per t'u arketuar, detyrimeve per t'u paguar dhe huave perafrohen me vlerat e tyre kontabel.

Te tjera

Instrumenta te tjere joderivative maten me kosto te amortizuar sipas metodes se interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvleresimi.

3.3 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve te vendetuara perfshin koston e materialeve dhe punes direkte, çdo kosto tjeter te lidhur drejtperdrejt me sjelljen e aktivitetit ne gjendje pune per qellimin e synuar te perdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes se pjeseve dhe sjelljes ne gjendjen e meparshme te vendndodhjes se aktivitetit. Shpenzimet kapitale te bera gjate ndertimit kapitalizohen ne "Ndertim ne proces" dhe transferohen ne kategorine perkatese te aktivitetit kur perfundon ndertimi tij, nga kur aplikohet amortizimi perkates sipas kategorise.

Ne rastet kur pjese te nje aktiviteti afatgjate material kane jetegjatesi te ndryshme, ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponentet me te medhenj) te aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur, dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave.

(ii) Kostot e mepasshme

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundshme qe shoqeria do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdorimi i pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jeten e vleresuar te çdo pjese te aktiviteti afatgjate material duke filluar nga dita e pare e muajit qe pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke perdorur metoden lineare te amortizimit mbi jeten e vleresuar te çdo pjese te aktiviteti afatgjate material dhe duke marre per baze periudhen me te shkurter midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Metodat dhe perqindjet e amortizimit per secilen kategori aktivesh afatgjata per periudhen aktuale jane si me poshte:

Permiresim ne qiramarrje	Mbi vleren kontabel neto	5%
Mobilje dhe orendi	Mbi vleren kontabel neto	20%
Pajisje dhe programe IT	Mbi vleren kontabel neto	25%
Te tjera aktive	Mbi vleren kontabel neto	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne çdo date raportimi.

CDK pack sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(shumat ne Lek)

3.4 Zhvleresimi

(i) Aktivet financiare

Nje aktiv financiar konsiderohet i zhvleresuar nese ka te dhena objektive qe tregojne se nje apo disa ngjarje kane efekte negative ne flukset e ardhshme qe parashikohet te burojne nga aktivi.

Nje zhvleresim ne lidhje me aktivin financiar, te matur me kosto te amortizuar, llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Aktivete financiare te rendesishme individualisht testohen per zhvleresim ne menyre individuale. Aktivete e tjera financiare vleresohen ne menyre te grupuar, ne grupe qe kane karakteristika te ngjashme te rezikut.

Te gjitha humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me nje aktiv financiar i disponueshem per shitje i njohur me pare ne kapital, njihet ne shpenzime.

Nje humbje nga zhvleresimi rimerret nese rimarrja mund te lidhet objektivisht me nje ngjarje te ndodhur pas njohjes se humbjes nga zhvleresimi. Per aktivete financiare te matura me kosto te amortizuar, rimarrja njihet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Aktivet jofinanciare

Vlera e mbetur e aktiveve jofinanciare te Shoqerise, rishikohet ne çdo date raportimi per te percaktuar nese ka te dhena per zhvleresim. Nese ka te dhena te tilla ateherë vleresohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Nje humbje nga zhvleresimi njihet nese vlera e mbetur e nje aktivi tejkalon vleren e tij te rikuperueshme. Humbjet nga zhvleresimi njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provigjonet

Nje provigjon njihet nese, si rezultat i nje ngjarjeje te shkuar, Shoqeria ka nje detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund te vleresohet ne menyre te besueshme dhe do te kerkoje flukse dalese parash per shlyerjen e tij. Provigjonet percaktohen duke skontuar flukset e pritshme te ardhshme te parase me nje norme skontimi para tatimit qe pasqyron vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe per risqet qe lidhen me detyrimin ne fjale.

3.6 Njohja e te ardhurave

Te ardhurat nga sherbimet e ofruara njihen ne pasqyren e te ardhurave ne varesi te fazes se perfundimit te transakcionit ne daten e bilancit. Asnje e ardhur nuk njihet nese ka pasiguri te larte lidhur me kryerjen e pageses dhe kostove perkatese.

3.7 Te ardhura dhe shpenzime financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhura interesi nga llogarite bankare dhe fitime nga kursi i kembimit qe njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Te ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare perfshijne shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i kembimit, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare te mbajtura me vlere te drejte nepermjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me metoden e interesit efektiv.

CDK pack sh.p.k.

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(shumat ne Lek)

3.8 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin perfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyre. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin njihet si fitim ose humbje perveç nese lidhet me zera te njohur direkt ne kapital, rast ne te cilin njihet ne kapital.

Tatimi aktual eshte tatimi qe pritet te paguhet mbi fitimin e tatueshem te vitit, duke perdorur normen tatimore ne fuqi ose qe konsiderohet ne fuqi ne daten e raportimit, dhe çdo sistemim te tatimit te pagueshem per vitet e meparshme.

Tatimi i shtyre lind nga ndryshimet mes vlerave te njohura per aktivet dhe detyrimet e shoqerise te paraqitura ne pasqyren e pozicionit financiar ne perputhje me kerkesat e SKK dhe vlerave te njohura te ketyre aktiveve dhe detyrimeve nga autoritetet tatimore.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

	31 dhjetor 2017
Llogari rrjedhese:	
Lek	110,908
Euro	6,885
	<u>117,793</u>
Arka:	
Lek	587,403
Euro	-
	<u>587,403</u>
TOTALI	<u>705,196</u>

5. Aktive financiare afatshkurtra

Aktivet financiare afatshkurtra me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

	31 dhjetor 2017
Kliente	-
Te tjera te arketueshme:	
TVSH per t'u marre	380,242
Debitore te tjere	-
TOTALI	<u>380,242</u>

6. Inventari

Inventari i Shoqerise me 31 dhjetor 2017 eshte:

CDK pack sh.p.k.
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur
me 31 dhjetor 2017

(shumat ne Lek)

	31 dhjetor 2017
Mallra per rishitje	2,075,262
TOTALI	2,075,262

7. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Shoqeria nuk ka parapagime dhe shpenzime te shtyra me 31 dhjetor 2017.

8. Aktive afatgjata materiale

Aktive afatgjata materiale ne date 31 dhjetor 2017 jane:

	Mjete transporti	Mobilje dhe orendi	Pajisje zyre dhe informatike	Permiresim ne qiramarrje	TOTALI
Kosto					
Shtesa			31,825	273,017	304,842
Pakesime					-
Me 31 dhjetor 2017	-	-	31,825	273,017	304,842
Amortizimi i akumuluar					
Shtesa			(3,313)		(3,313)
Pakesime	-	-	-	-	-
Me 31 dhjetor 2017	-	-	(3,313)	-	(3,313)
Vlera e mbetur					
Me 31 dhjetor 2017	-	-	28,512	273,017	301,529

9. Detyrimet per t'u paguar dhe parapagime

Detyrimet per t'u paguar dhe parapagimet me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

	31 dhjetor 2017
Furnitore	1,789,067
Detyrime ndaj personelit	42,624
Tatime dhe taksa:	
Sigurime shoqerore dhe shendetesore	13,392
Kreditore te tjere	1,740,662
TOTALI	3,585,745

10. Detyrime afatgjata

CDK pack sh.p.k.
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(shumat ne Lek)

Shoqeria nuk ka detyrime afatgjata me 31 dhjetor 2017.

11. Te ardhura nga aktiviteti

Te ardhurat nga aktiviteti per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 jane 3,558,202 Leke.

12. Shpenzime administrative

Shpenzimet administrative per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 perbehen si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Shpenzime per qira per magazinën	324,020
Shpenzime te tjera	12,338
Shpenzime per konsulence financiare	53,344
Shpenzime konsulence ligjore	1,000
Taksa vendore	10,500
TOTALI	401,202

13. Kosto e punes

Kostoja e punes me 31 dhjetor 2017 perbehet si me poshte:

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Pagat dhe shperblimet e personelit	213,230
Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetesore	35,610
TOTALI	248,840

14. Te ardhura (shpenzime) nga kurset e kembimit, neto

Te ardhurat (shpenzimet) nga kurset e kembimit per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 jane si me poshte :

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Fitime te realizuara nga kursi i kembimit	-
Fitime te perealizuara nga kursi i kembimit	-
	-
Humbje te realizuara nga kursi i kembimit	(5,034)
Humbje te perealizuara nga kursi i kembimit	(6,414)
	(11,448)
TOTALI	(11,448)

CDK pack sh.p.k.
Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017

(shumat ne Lek)

15. Te ardhura (shpenzime) te tjera financiare, neto

Te ardhurat (shpenzimet) te tjera financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017 jane si me poshte :

	Viti i mbyllur me 31 dhjetor 2017
Shpenzime per komisione bankare	(17,740)
TOTALI	(17,740)

16 Tatim-fitimi

Bazuar ne legjislacionin shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin i thjeshtua eshte 5%.

Deklaratat tatimore dorezohen çdo vit por te ardhurat dhe shpenzimet e deklaruar per qellime tatimi konsiderohen vetedeklarime deri ne momentin qe autoritetet tatimore shqyrtojne deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe leshojne vleresimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare jane objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Me 31 dhjetor 2017, Shoqeria nuk ka detyrime apo aktive tatimore te shtyra.

17. Angazhime dhe pasiguri

Gjate aktivitetit te saj te zakonshem, Shoqeria mund te perfshihet ne pretendime apo veprime te ndryshme ligjore nga pale te treta. Me 31 dhjetor 2017 Shoqeria nuk ka çeshtje apo pretendime qe do te kene efekt negativ ne pozicionin financiar te Shoqerise ose ndryshime ne aktivet neto te saj. Gjithashtu, me 31 dhjetor 2017, Shoqeria nuk ka angazhuar kapitale te kontraktuara por ende te papaguara.

18. Ngjarje te mepasshme

Nuk ka asnje ngjarje te mepasshme pas dates se raportimit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.